# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-423776**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Berisha: Greqia ul çmimet, qeveria shqiptare 0 reagim, të hiqet TVSH-ja për ushqimet – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/berisha-greqia-ul-cmimet-qeveria-shqiptare-0-reagim-te-hiqet-tvsh-ja-per-ushqimet/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 05:17:20 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 31 gusht 2026, 10:27:53 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `02c0059ef28dabe51d3300e9a0c610b955a276422c3cc9150a094f4c8843aea3` |
| TEKSTI | `82f689ba90f4a39025a2c1cf23fa5bd6d6a5f847ac0869c014fbafa15c7712c8` |
| PAMJA | `85644a2683a465ead380e5e414c2701d91710db8cc3d2f6be191e005e1a73c8b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4986670528578abfa5c246dd67d5a7a96556a4bfc046b968b411f68f1441c22f` |
| E MËPARSHMJA | `3d2ecffb7a0d778acb50bcab5d11720d319717c8c5e0ef57770611f6f94ed69b` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4986670528578abfa5c246dd67d5a7a96556a4bfc046b968b411f68f1441c22f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

menjëhershme të TVSH-së për ushqimet dhe masa të tjera sociale për familjet shqiptare.

Në një deklaratë për mediat nga selia blu, Berisha tha se qeveria greke ka ndërmarrë një nismë për uljen e çmimeve të më shumë se 1,600 produkteve, me zbritje që variojnë nga 5 deri në 30 për qind.

Sipas tij, masat në Greqi përfshijnë produkte bazë ushqimore, artikuj me konsum të gjerë familjar, si dhe mjete shkollore për fëmijët, ndërsa theksoi se këto ndërhyrje po ndërmerren edhe pse qytetarët grekë kanë të ardhura dukshëm më të larta se shqiptarët.

“Greqia ka vendosur të ulë me 5-30% koston e çmimeve të 1600 artikujve, ushqimeve bazë, të të gjitha mjeteve shkollore për fëmijët, të produkteve me konsumim të gjerë nga konsumatorët në shtëpi”, deklaroi Berisha.

Ai e krahasoi këtë politikë me situatën në Shqipëri, ku, sipas të dhënave të fundit të Eurostat, çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike janë rritur me ritme më të larta se në Bashkimin Europian.

Berisha akuzoi qeverinë shqiptare për mungesë reagimi dhe ndërhyrjeje përballë rritjes së kostos së jetesës.

“Ndërkohë çmimet në Shqipëri, sipas statistikave më të fundit, u rritën këtë vit 5 herë më shumë se mesatarja e vendeve të BE. Qeveria ka zero reagim”, u shpreh ai.

Kreu i PD-së e cilësoi situatën si alarmante, duke pretenduar se një pjesë e

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

konsiderueshme e qytetarëve shqiptarë përballen me vështirësi për të përballuar shpenzimet bazë.

“Janë kambana të trishta alarmi që bien në këtë vend. Indiferenca e Ramës dhe qeverisë së tij ndaj këtaj situate tejkalon qëndrimet më çnjerëzore”, deklaroi Berisha.

Në vijim të deklaratës, Berisha renditi disa nga masat që Partia Demokratike i konsideron të domosdoshme për lehtësimin e familjeve shqiptare. Sipas tij, prioritet duhet të jetë heqja e menjëhershme e TVSH-së për ushqimet, subvencionimi i plotë i shpenzimeve për shkollën dhe vendosja e minimumit jetik.

Berisha argumentoi se këto masa do të ndihmonin familjet shqiptare përballë kostos së lartë të jetesës dhe rritjes së çmimeve të produkteve bazë. Në fund të deklaratës, lideri demokrat e ashpërsoi gjuhën ndaj qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama, duke e akuzuar këtë të fundit se është shkëputur nga problemet e qytetarëve.

#Berisha #Çmimet #Greqi

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI
**Nis viti i ri shkollor, Skënder Hita mesaz...**
Xhuljana Zhuleku 11 minuta më parë



VENDI
**Alarmi i rremë për bombë në shkollën...**
Xhuljana Zhuleku 18 minuta më parë



EKONOMI
**Nafta “kapërcen” 230 lekë për litër,...**
Xhuljana Zhuleku 45 minuta më parë

Lajme
Politikë
Programe
Programe
Rrjeti
Rreth nesh
Ligjore
Kushtet e përdorimit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.